

## Konferencë rajonale

*Roli i Parlamenteve në Nxitjen e Konkureshmërisë dhe Rritjes Ekonomike duke Përmirësuar Klimën e Biznesit në Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, Beograd, 06-07 mars, 2009*

### DEKLARATË

Kriza financiare aktuale filloi si krizë e tregut të hipotekave në SHBA, për t'u zhvilluar më pas në një krizë financiare dhe ekonomike globale që u përhap si në vendet e zhvilluara perëndimore ashtu dhe në vendet në zhvillim dhe në tranzicion. Patëm një ngadalësim të rritjes ekonomike në nivel global, madje edhe një rënie reale të PBB-së. Tregjet e vendeve në zhvillim dhe në tranzicion u goditën pothuajse menjëherë nga një ndërprerje e papritur e fluksit të kapitalit, pasi investitorët nuk ishin të gatshëm të ekspozoheshin ndaj rreziqeve të investimeve në kohë krize. Goditja ishte veçanërisht intensive për vendet në tranzicion, përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi ato janë shumë të varura nga importi i kapitalit dhe kanë bilance të larta të defiçitit të pagesave.

Përveç vështirësive që lidhen me fluksin e hyrjes së kapitalit, në vendet e Ballkanit Perëndimor ndikimet e krizës janë manifestuar edhe në rënien e eksporteve për shkak të dobësimit të kërkesës së jashtme për produktet e rajonit, e cila më pas ka sjellë ulje të prodhimit, rritje të mungesës së likuiditetit ekonomik, rritje të papunësisë, ulje të ritmit të rritjes ekonomike, madje edhe ulje të PBB-së reale.

Në këtë moment të rëndësishëm në botë, Europa, si edhe ky rajon si pjesë e Europës, duhet të rrisë ndërgjegjësimin mes parlamenteve të rajonit mbi madhësinë, thellësinë dhe kohëzgjatjen e krizës dhe gjithçka që ajo mund të sjellë. Kjo krizë ka goditur rajonin në momentin më të keq të mundshëm. Është realiste të pritet se komuniteti ndërkombëtar, madje edhe Bashkimi Evropian, nuk do të jetë i përfshirë në rajon në nivelin e 20 viteve të fundit, pasi pothuajse e tërë energjia politike e peizazhit politik European do të drejtohet drejt zgjidhjes së krizës në BE. Kjo patjetër kërkon përgjegjshmëri më të madhe politike dhe vetë-përgjegjësi të liderëve politikë dhe udhëheqësve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Kriza, në mënyrë graduale por të pashmangshme, po vjen në rajonin tonë dhe ky vit do të jetë vendimtar për tërë perspektivën historike dhe strategjike të rajonit. Kjo krizë duhet të ballafaqohet me një ndjenjë solidariteti, bashkërisht dhe në mënyrë të koordinuar nga ana e rajonit si i tërë, përmes aktiviteteve të përbashkëta të të gjithë qeverive dhe parlamenteve të rajonit. Është gjithashtu e nevojshme ruajta e perspektivës europiane të vendeve të rajonit,

përsheptimi i reformave dhe fillimi i punës, sa më shpejt të jetë e mundur, për zgjidhjen e konflikteve të pazgjidhura në rajon.

Parlamentet duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në përballimin e krizës ekonomike dhe në marrjen e masave të nevojshme për kapërcimin e saj, duke pasur parasysh se na pret epoka e regjimeve rregullatore, si në nivel global ashtu dhe kombëtar. Ky fakt vetëm përsërit rëndësinë e parlamenteve në vitet që kemi përpara. Në këto kohë të vështira, edhe më shumë se në ato të zakonshmet, është e rëndësishme nxitja e regjimeve rregullatore të favorshme për zhvillimin e sipërmarrjes dhe sektorit privat. Nxitja e një mjedisi të favorshëm biznesi nuk është vetëm përgjegjësi e qeverive, por në të njëjtën masë, edhe e parlamenteve.

Parlamenti dhe komisionet parlamentare, në këtë kohë krize, duhet të jenë më proaktive dhe të marrin një pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë për tejkalimin e krizës. Këtu nuk kemi parasysh vetëm rolin legjislativ të parlamenteve, i cili lidhet me miratimin e regjimeve rregullatore të mjaftueshme, por edhe funksionin e tyre të kontrollit, në mënyrë që parlamentet të jenë në gjendje të monitorojnë zbatimin si dhe pikat e forta dhe të dobëta të rregulloreve të miratuara.

Zhvillimi i një kuadri ligjor dhe rregullator cilësor do të jetë një nga parakushtet më të rëndësishme për tërheqjen e kapitalit të huaj në vendet e rajonit. Hyrja e kapitalit është reduktuar fuqishëm në këtë kohë krize. Në këtë proces, *roli legjislativ i parlamenteve* do të fitojë në rëndësi, si në aspektin e harmonizimit të legjislacionit vendas me legjislacionin e Bashkimit Europian, edhe në miratimin e rregulloreve si një masë për tejkalimin e krizës. Në mënyrë që ky kuadër ligjor dhe rregullator të jetë sa më cilësor të jetë e mundur, gjatë harmonizimit të rregulloreve kombëtare me legjislacionin e BE-së, duhet të kihet parasysh se në atë proces duhet të bëhet edhe harmonizimi i brendshëm i legjislacionit kombëtar. Përndryshe do të ndesheshim me probleme në zbatimin e ligjeve, ndaj të cilit kapitali i huaj është shumë i ndjeshëm.

Nga ana tjetër, gjatë harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*, vendet e rajonit po harmonizojnë edhe legjislacionet mes tyre, duke krijuar kështu një kuadër ligjor dhe rregullator rajonal të harmonizuar, që përben një avantazh shtesë për tërheqjen e investimeve të mëdha rajonale.

Në procesin e tranzicionit, vendet e rajonit kanë liberalizuar ekonomitë e tyre në mënyrë të konsiderueshme. Tani kur vendet e zhvilluara perëndimore, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe shtetet anëtare të BE-së janë duke rifutur prerogativa të caktuara që po kufizojnë liritë e tregut, edhe vendet e rajonit do të duhet të bëjnë ndryshime të regjimeve rregullatore në mënyrë që të përballojnë ndikimet negative të krizës.

***Funksioni i kontrollit parlamentar*** ka qenë lënë deri diku pas dore, por në këtë kohë krize ky funksion po fiton rëndësi. Parlamentet e vendeve të Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga mungesa e traditës parlamentare dhe demokratike, dhe ky fakt po e nxit pushtetin ekzekutiv në vendet e rajonit drejt shtrirjes së përhershme të kompetencave dhe mjeteve të ndikimit të tij në marrëdhënie me parlamentin. Megjithatë, në një kohë krize financiare dhe ekonomike parlamenti nuk mund të pranojë një rol pasiv dhe të lërë qeverinë të përgatisë paketën e masave, të udhëheqë nëpërmjet urdhërave dhe akteve nënligjore, si dhe e vetme të marrë përgjegjësinë për veprimtarinë e vet dhe për të ardhmen e vendit. Kjo në fakt do të thoshte që si deputetët në pushtet ashtu dhe ata të opozitës nuk do të kishin përgjegjësi për çfarëdolloj gjëje që mund ndodhë.

Në këtë drejtim, ka nevojë të përmirësohet koordinimi brenda parlamenteve dhe komisioneve të tyre parlamentare, si dhe bashkëpunimi i të gjitha partive parlamentare, me qëllim kapërcimin e shpejtë dhe me efikasitet të krizës. Edhe deri më tani, parlamentet në rajon kanë qenë pengesa e vetme mes tendencës mjaft të natyrshme të pushtetit ekzekutiv për të kaluar në autoritarizëm dhe përpjekjeve për të krijuar demokraci pak a shumë të përgjegjshme.

Çështje të rëndësishme, si zgjedhja nëse përparësi duhet t'i jepet shkurtimit të shpenzimeve publike apo stimulimit të ekonomisë, rritjes së ekonomisë kombëtare apo çështjeve sociale, si dhe çështjet që lidhen me cilësinë e gjyqësorit, mund të shqyrtohen edhe në seanca parlamentare.

Nuk mund të pritet që ndonjë vend i rajonit të mund të kapërcejë krizën më vete, pa pjesën tjetër të rajonit. Kriza mund të shihet si një mundësi për arritjen e një politike dhe konsensusi të mjaftueshëm e të përgjegjshëm të qeverisë dhe institucioneve të tjera. Ajo nuk është vetëm një mundësi, por gjithashtu nxjerr në pah nevojën e një bashkëpunimi më të fortë rajonal, që do të mundësonte shkëmbimin më të shpejtë të përvojave dhe shmangien e gabimeve.

Duke ndarë probleme të ngjashme dhe trashëgimi të ngjashme, parlamentarët e vendeve të rajonit gjithashtu mund të ndajnë përpjekje të përbashkëta për krijimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë në rajon, për të mirën e qytetarëve të cilët i kanë zgjedhur ata në parlamentet e tyre kombëtare. Konteksti i krizës financiare dhe ekonomike, në këtë rajon relativisht të varfër, duhet të shihet përmes prizmit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të luftës kundër varfërisë. Në të kundërt, mund të ndodhë që një numër i madh njerëzish në vendet e rajonit, të arrijnë në një situatë të pashpresë. Në këtë kontekst, anëtarët e parlamenteve kanë përgjegjësi t'u tregojnë qytetarëve që ata përfaqësojnë se reformat janë ende të mundura dhe se një jetë më e mirë është e mundur, që kriza do të kalojë, dhe se kjo do të ndodhë në sajë të rregulloreve që do të miratohen në parlamente.

## **Ngritja e Rrjetit Rajonal të Komisioneve Parlamentare për Ekonomi dhe Financa të vendeve të Ballkanit Perëndimor**

Konkluzionet përfundimtare të Konferencës ishin se është në të mirën e vendeve të rajonit që bashkëpunimi mes Komisioneve Parlamentare të Ekonomisë dhe Financave të vendeve të Ballkanit Perëndimor të zyrtarizohej përmes krijimit të një Rrjeti Rajonal të Komisioneve.

Përftimet e pasjes së një rrjeti të tillë janë bazuar në faktet e mëposhtme:

- Të gjitha vendet e rajonit, përveç Shqipërisë, ndajnë trashëgiminë dhe përvojën e përbashkët të ish-Jugosllavisë, përfshirë këtu tregun e përbashkët, regjimin rregullator të përbashkët dhe gjuhën e ngjashme;
- Të gjitha vendet në rajon janë në procesin e integrimi europiane, dhe paralelisht me harmonizimin e legjislacioneve kombëtare me atë europian, vendet e rajonit janë gjithashtu duke harmonizuar legjislacionet mes tyre, duke krijuar kështu një kuadër legjislativ të harmonizuar në nivel rajonal.

Në këtë drejtim, u ra dakord që fushat e bashkëpunimit duhet të mbulojnë:

- Ndarjen e informacionit në fushën e ekonomisë dhe legjislacionit ekonomik;
- Monitorimin e metodologjisë së propozimit të rregulloreve, dhe rolin e Komisioneve dhe organeve që punojnë në këtë proces;
- Harmonizimin me legjislacionin europian të rregulloreve në fuqi;
- Monitorimin e procedurës së propozimit të ligjeve, veçanërisht atyre që i referohen harmonizimit të rregulloreve me legjislacionin europian.

Për shkak të kapaciteteve të pabarabarta të stafit dhe ekspertëve në komisione dhe në përgjithësi, përvoja e atyre që janë më të avancuar do të jetë me dobi të madhe për vendet që janë më prapa.

Ne vlerësojmë bashkëpunimin e deritanishëm dhe mbështetjen e IFC dhe GTZ dhe shpresojmë se ajo do të vazhdojë në të ardhmen, pasi kjo do të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për funksionimin më efikas të këtij Rrjeti Rajonal.

Ndoshta është herët për të shtjelluar në mënyrë të detajuar funksionimin e Rrjetit në të ardhmen, por kemi disa mundësi: (i) ngritjen e një Zyre të Përbashkët Bashkëpunimi (ii) ushtrimin e bashkëpunimit përmes organeve të ekspertizës parlamentare; (iii) organizimin e mbledhjeve të përfaqësuesve të Komisioneve dy-tri herë në vit në disa nga parlamentet anëtare për ndarjen e informacionit dhe përvojave në vend, (iv) ndonjë formë tjetër komunikimi, duke përfshirë shkëmbimin e planeve vjetore të punës, mundësi për të marrë pjesë në punën e komisioneve të parlamenteve (vendeve) të tjera (v) mundësi për të qenë të pranishëm kur merren vendime në komisione, si dhe nga organizimi i seancave të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit parlamentar bilateral dhe multilateral, kur diskutohen projekte infrastrukturore kyçe dhe çështje me rëndësi për të gjithë rajonin.

Krijimi i këtij rrjeti do të nisë një proces bashkëpunimi që më vonë mund të zhvillohet në një formë më të lartë bashkëpunimi, jo vetëm mes Komisioneve Parlamentare të Ekonomisë dhe Financave, por mes parlamenteve në përgjithësi.

1. Forcimi i funksionit legjislativ të parlamenteve, për përmirësimin e cilësisë së ligjeve nëpërmjet:
  - Ndërtimit të kapaciteteve të ekspertizës dhe kapaciteteve financiare të parlamenteve për hartimin e ligjeve;
  - Futjes së procedurave transparente të miratimit të ligjeve;
  - Forcimit të rolit të komisioneve parlamentare në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve;
  - Përmirësimin të cilësisë së legjislacionit që rregullon punën e parlamenteve në vendet e rajonit.
2. Përmirësimi i funksionit të kontrollit parlamentar me qëllim përmirësimin e zbatimit të ligjeve, nëpërmjet një kontrolli më të fortë parlamentar mbi ekzekutivin.
3. Rëndësia e ruajtjes së perspektivave europiane për vendet e rajonit, në kohën e krizës financiare dhe ekonomike globale.
4. Forcimi i bashkëpunimit parlamentar rajonal për ndarjen e njohurive dhe përvojave në fusha me interes të përbashkët, duke përfshirë:
  - Procesin e anëtarësimit të Bashkimit Evropian, si dhe harmonizimin me legjislacionin evropian;
  - Përballjen me krizën financiare globale që po kthehet në një recesion të përmasave globale.

5. Krijimi i një platformë rajonale për luftën kundër ndikimeve të krizës në rajon, nëpërmjet:

- Bashkëpunimit të komisioneve parlamentare për ekonomi dhe financa, brenda rrjetit krijuar në këtë konferencë;
- Ndarjes së informacionit mbi aktivitetet e komisioneve;
- Punës së përbashkët të rrjetit të komisioneve në gjetjen e zgjidhjeve optimale në procesin e krijimit të një të mjedisi të favorshëm ligjor dhe investues në vendet e rajonit.

6. Shfrytëzimi i përvojave të vendeve të rajonit, nëpërmjet:

- Programeve arsimuese dhe trajnuese për deputetët dhe personelin parlamentar;
- Ndarjes së botimeve përkatëse dhe organizimit të vizitave studimore;
- Programeve ndërkombëtare të asistencës.